



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2019:180051

Datë: 20.02.2025

Numri i dokumentit: 06876039

**C.nr.423/19**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA LIPJAN, Departamenti i Përgjithsëm-Divizioni Civil**, me gjyqtarin individual Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gentiana Dakaj, në çështjen juridiko-civile të paditësve-kundërpaditurve R. G., R. G., S. G. dhe H. G. që të gjithë nga fsh. H. i V. K. L., të cilët i përfaqëson Bahtir Troshupa av. në Prishtinë, me autorizim, ndaj të paditurve-kundërpaditësve M. G., nga fsh. H. i V., J. G., M. K., M. K., H. K.-Z., nga fsh. G. e E., të cilët i përfaqëson Ekrem Agushi av. nga Prishtina, me objekt kontesti vërtetim pronësire, në shqyrtimin kryesor, publik të mbajtur në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, me dt.28.01.2025, merr këtë:

## A K T G J Y K I M

**I. APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e precizuar e paditësve-kundërpaditurve R. G., R. G., S. Go. që të gjithë nga fsh. H. i V. K. L. dhe H. K.-Z. nga fsh. G. e E. dhe **VËRTETOHET** se paditësit e kanë fituar të drejtën e pronësisë në bazë të trashëgimisë të të ndjerit H. G. ish nga fsh. H. i V. secili nga 1/7 e masës së trashëgimisë dhe atë: ngastrave nr...., ..., ..., ..., ..., ..., ..., ... dhe ngastra kadastrale nr.... që gjinden në ZK H. i V. si dhe secili nga 1/7 e pjesës ideale në ngastren .. që gjindet në ZK R. i V. (e cila kjo e fundit gjindet në emër të paraardhësit të palëve ndërgjyqëse) dhe **DETYROHEN** të paditurit M. G. nga fsh. H. i V. dhe të paditurit e tjerë J. G., M. K., M.K., dhe H. K.-Z., që paditësve t'ia njoh të drejtën e pronësisë në ngastrat e përmendura më lartë në ZK H. i V. dhe njëherit detyrohet i padituri që si pasardhës të të ndjerit H. G. ish nga fsh. H. i V. t'ia njohë të drejtën e pronësisë paditësve pra të ngastres në nr... ZK R. i V., si dhe t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1,163.20-€, të gjitha këto në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, ose ky aktgjykim do të shërbej si titull juridik për regjistrim në regjistrat kadastral.

**II. APROVOHET** si e bazuar kundërpadia e të paditurit M. G. nga fsh. H. i V. dhe **VËRTETOHET** se kundërpaditësi e ka fituar të drejtën e pronësisë në bazë të trashëgimisë dhe atë në 3/7 në parcelën me nr... që gjinden në ZK R. i V., e cila ngastër regjistrohet në emër të paraardhësit të palëve ndërgjyqëse dhe detyrohen të gjithë paditësit-kundërtëpaditurit që paditësit t'ia njohin të drejtën e pronësisë në këtë ngastër në të kundërten ky aktgjykim do të shërbej si titull juridik për regjistrim pranë regjistrave kadastral KK Lipjan, të gjitha këto në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

Paditësit-kundërtëpaditurit R. G., R. G., S. G. dhe H. G. që të gjithë nga fsh. H. i V. K. L., për shkak të anulimit të vendimit të trashëgimisë. Në padi kanë theksuar se është fakt notor që shqiptarët në Kosovë shumë herë në rrugë jashtë gjyqësore i kanë rregulluar raportet familjare, ato pasurore dhe qarkullimin e palujtshmerive, gjithashtu edhe parasardhësit e H. G.-N. Govori,

R. G., R. G., S. G., H. G., M. G., J. G., Q. G.. Pas vitit 2000 në rrugë jashtë gjyqësore e në bazë të rregullave tradicionale në bazë të marrvëshjes së pashkruar janë pajtuar për ndarjen e masës së trashëgimisë së trashëgimlënsit të tyre. Bashkëshortja e të ndjerit N. G., vajza e të ndjerit Q. G., nuk kanë dashur të trashëgojnë, ndërsa vëllau J. është pajtuar që pasuria që ati i takon të trashëgon M. G.. Gjithashtu ka theksuar se pasardhësit e tjerë kanë pranuar të e ndajnë pasurinë sipas ligjit, ndarja fizike ka mbetur çështje kohe edhe për shkak se nuk kanë pasur interesim të merren me bujqësi, por janë pajtuar që toka të mos mbetet djerrin dhe të punohet nga vëllau M. G., deri në ndarjen fizike, ndërsa shpelljen formale për trashëgimtare e kanë lënë pasi që të bëhet ndarja fizike dhe eksperti i gjeodezisë të bëjë matjet në teren dhe krijimin e ngastrave. I padituri me keq dashje dhe në kundërshtim me ligjin dhe duke e vënë në lajthim zyrtarin e gjendjes civile në Lipjan i ka fshehur pasardhësit e H. G., tani paditësit dhe është lëshuar dëshmi vdekje duke i anashkalur paditësit. Rrjedhimisht e ka vënë në lajthim edhe Gjykatën në Lipjan dhe i padituri është shpallur trashëgimtar i vetëm i masës së trashëgimisë së trashëgimlënsit H. G..

Në shqyrtimin kryesor e ka precizuar kërkesëpadinë më konkretisht si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësve-kundërpaditurve ka deklaruar se mbetet në tërësi si në padi dhe parashtresës për precizim të kërkesëpadiës të dt.31.05.2024 duke shtuar se objekt shqyrtimi kemi vërtetimin e pronësisë në bazë të trashëgimisë të të ndjerit H. G. i cili ka ndërruar jetë në vitin 1996 dhe nga të gjitha provat është vërtetuar se i ndjeri ka lënë pas vete 7 pasardhës që janë përmendur, ndërsa paditësit janë djemt e tij R., R., S. dhe H. G. dhe të njëjtit janë përjashtuar nga pjesëmarrja në shqyrtimin e trashëgimisë nga pasardhësi tjetër këtu i padituri M. G. i cili në bazë të vendimit të trashëgimisë që është përmendur më lartë është shpallur trashëgimtar i vetëm i të ndjerit H. G. ish nga fsh. H. i V., andaj mbi bazën e trashëgimisë ka kërkuar vërtetimin e pronësisë në 1/7 për secilin paditës veç e veç në ngastrat që kanë qenë objekt vendimi të trashëgimisë dhe ngastrës tjetër e cila ende gjindet në emër të paraardhësit të ndërgjyqësve. Pra, nga të gjitha provat që janë vërtetuar kjo e drejtë që i takon paditësve dhe nuk është kontestuese edhe nga të paditurit, duke i propozuar gjykatës që e njëjta të aprovohet si e bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Në të përgjigjur në padi i autorizuari i të padituri-kundërpaditësve ka shtuar se padia e paditësit nuk i përmban të gjitha elementet e përcaktuara me dispozitat e nenit 353 al.1 pika a), b), c) d) dhe e) të LPK-së për të gjykuar meritorisht, me arsyetim se në padi nuk është theksuar baza juridike e padisë, ndërsa me kërkesëpadinë e propozuar në pikën 1. nuk mund të kërkohej anulimi i aktvendimi i Gjykatës Komunale në Lipjan, T.nr.... i dt.02.09.201 me arsyetim se anulimi i aktvendimit mund të bëhet vetëm me ankes dhe mjete të jashtëzakonshme juridike, ndërsa në kërkesëpadinë e propozuar si në pikën 2 nuk e është identifikuar masa e trashëgimisë, e cila është përshkruar detaisht në aktvendim të trashëgimisë me të dhëna gjeodezike, në të cilën paditësit pretendojnë se e kanë fituar të drejtën e bashkëpronësisë 1/6 pjesë të paluajtshmërisë nga masa e trashëgimisë së trashëgimlënsit H. G.. Paditësit me provat e paraqitura nuk kanë arritur që ta vërtetojnë ekzistimin e legjitimitet aktiv të palës në procedurë për të kërkuar vërtetimin e pronësisë mbi bazën e trashëgimisë, këtë sepse në përmbajtjen e padisë e pohojnë faktin se sipas rregullave tradicionale në bazë të marrvëshjes janë pajtuar për ndarjen e masës së trashëgimisë së trashëgimtarëve, por nuk theksohet se në cilat njësi kadastrale kanë hy në posedim dhe shfrytëzim secili pjesëmarrës i marrvëshjes veç e veç, të cilat e përbëjnë trashëgimin e trashëgimlënsit - babait të ndërgjyqësve. Nga të gjitha faktet dhe provat e paraqitura, i padituri i propozon gjykatës që padinë e paditësve t'ia kthejë të autorizuarit të tyre që brenda afatit gjyqësor ta bëjë rregullimin e saj në pajtim me kundërshtimet e paraqitura.

Në shqyrtimin kryesor i autorizuari i të paditurve-kundërpaditësit M. G. ka parashtruar kundërpadi si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari e të paditurve-kundërpaditësve ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë kërkesës së parashtruar me kundërpadi dhe ka shtuar se që nga fillimi i procedurës kontestimore lidhur me këtë çështje kontestuese të paditurit nuk e kanë kontestuar

pjesën e kërkesëpadisë së paditësve që ka të bëjë me fitimin e së drejtës së pronësisë secilit nga 1/7 pjesë. Pala paditëse gjatë procedurës e ka kontestuar propozimin e të paditurve për sa i përket pohimi të kërkesëpadisë së tyre për fitimin të pronësisë nga 1/7 pjesë, andaj i ka propozuar gjykatës që të vendos meritorisht lidhur me kërkesëpadinë dhe kundërpadinë në mënyrë që palët ndërgjyqëse ta zgjidhin përfundimisht kontestin e tyre. Për sa i përket njësisë kadastrale nr.... e njëjta mbi bazën e kontratës është bartur dhe regjistruar në pronësi të J. J., i cili e posedon dhe e shfrytëzon pa ndërprerje këtë njësi kadastrale pa u penguar dhe pa u shqetësuar nga paditësi R. G. dhe të tjeret, për më tepër kjo palujtshmëri si e tillë në regjistrat e palujtshmërive në ZKK Lipjan është regjistruar dhe është lejuar si njësi me dt.01.05.2012 fakt ky i vërtetuar me certifikatë për njësinë kadastrale ... e lëshuar nga ZKK në Lipjan.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për vërtetimin e gjendjes faktike në këtë çështje kontestimore, gjykata në riprocedurë ka bërë administrimin e provave dhe atë shiqimin dhe leximin e aktvendimit të trashëgimisë të kësaj gjykate T.nr... të dt.02.09.2011, me shiqimin dhe leximin e certifikatave të lindjes për M. G., R. G., R. G., J. G. dhe H. G., me shiqimin dhe leximin e aktit të vdekjes i lëshuar nga Shërbimi i Ofiqarisë në Lipjan të dt.16.08.2011, me shiqimin dhe leximin e certifikatës së pronësisë nr.4161/18 e dt.04.10.2018, me shiqimin dhe leximin e certifikatës së vdekjes për të ndjerën Q. K. vjaza e të ndjerit H. G., së bashku me certifikatën e lindjes për M., M. K. dhe H. K.-Z., me shiqimin dhe leximin e historiatit të lëshuar nga Komuna e Lipjanit dt.23.05.2024 dhe certifikatat e bashkangjitura, me dëgjimin e e të paditurve në cilësin e palës në procedurë M. G., J. G., H. G., R. G., M. G., R. G., dhe pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, në pajtim me nenin 8 të LPK-së, gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësve-kundërpropozusve është e bazuar, për çka edhe e aprovoi në tërësi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga aktvendimi i trashëgimisë të kësaj gjykate T.nr.... të dt.02.09.2011, gjykata vërtetoi faktin se trashëgimia e trashëgimlënësit H. G. ish nga fsh. H. i V. i cili ka vdekur nga vdekja natyrale me dt.26.08.1996 nuk ka lënë testament e as kontrat mbi mbajtjen e përrjetshme ku e gjithë pasuria e përshkruar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi si trashëgimtar i rendit të parë ligjor të tërë pasurisë trashëgimore është shpallur i padituri-kundërpaditësi M. G. nga fsh. H. i V., i biri i të ndjerit.

Nga certifikatat e lindjes që gjinden në shkresat e lëndës për M. G., R. G., R. G., J. G., S. G., H. G. dhe Q. K. (e cila ka ndërruar jetë me dt.26.04.2012), dhe pas vetës ka lënë fëmijët M., M. K. dhe H. Z.-K., këta të fundit sipas të drejtës së përfaqësimit, vërtetohet se i ndjeri respektivisht paraardhësi i ndërgjyqësve H. G.ish nga fsh. H. i V. ka ndërruar jetë me dt.26.08.1996 dhe pas vetës si pasardhës ka lënë pasardhësit e lartëpëmendur, pra gjithëses 7 fëmijë.

Nga dëshmia e të paditurit **M. G.** në cilësin e palës në procedurë ka deklaruar se në bashkësi familjare me prindërit dhe vllëzerit ka jetuar deri në vitin 1991 e tutje ku ka qenë kryefamiljar pa kurfarë përkrahje, ndërsa ka jetuar me prindërit e ku edhe motra ka qenë me të deri në muajin shkurt të vitit 1993, pasurin e paluajshme e ka krijuar në bashkësi familjare me babën, vëllëzrit, motrat kurse në vitin 1996 pasi babai ka ndërruar jetë me 26.08.1996 është blerë livadhi në sipërfaqe prej 41 ari, e ku ka marrë pjesë R., R. dhe H., ku me paret e këtyre është blerë kjo tokë dhe në emër të tyre e ka bërë pazar prej I. G. nga fshati H. i V., livadhi në sipërfaqe prej 42 ari, e ka blerë babai i tyre prej E. G. nga fshati H. i V., kjo arë është blerë me parët e përbashkëta të babës, të mijat dhe vëllëzerve. Poashtu ka shtuar se arën në sipërfaqe prej 67 ari me nr.513 ZK H. i Vogël, kjo parcel është blerë në vitet 70 ta dhe me sa i kujtohet me kontributin më të madh e ka dhënë vëllau i madh S. G. edhe kjo tokë është blerë për nevojat e familjes. Ara që e quajn ara perte Xh. është blerë nga mjetet e përbashkëta të familjes dhe atë është blerë diku ka fundi i viteve 60 saktësisht nuk i kujtohet, kjo arë është blerë me mjete të babës dhe familjareve tjerë që kanë punuar bashkarisht dhe këtë arë për të Xh. une e punoj prej se ka met vet e deri sot e kësaj dite dhe me sa e dinë një pjesë është në emër të tij të cilën e ka qit gjatë vitit 2011, një pjesë duket se është në emër të Komunës si pronë e Komunës dhe se në qfarë mënyre e ka qitë në emër nuk i kujtohet por toka që ka qenë në emër të prindit e ka qitur në emër të tij,

këtë e ka deklaruar në Komun. Para se me qitë në emër të tij ara përtej Xhëka qenë në emër të babit të tij të ndjer dhe në arën përtej Xh. nuk ka qitë, ara për te Së është ende në emër të babës e cila i ka 67 ari, këtë arë është duke e punuar me miser, grun e kultura tjera bujqësore. Gjithashtu ka deklaruar se pasurin trashëgimore të babës me trashëgim e ka qit në emër të tij për ti marrë subvencionet, këtë për faktin se ka pas problem ti grumbulloj vëllëzerit dhe motrat të cilët gjinden në botën e jashtme ndërsa nuk ka pas qëllim që tokën e babës të ja marrë vëllëzerve dhe deri në vitin 2011 kurrë nuk është përmendur nga vëllëzerit ndarja e tokës, vëllaut i ka thënë dajë por dajë drejtë, ndërsa djali i R., M. është ardhë nga perëndimi dhe mu ka drejtu me fjalët pse spe lenë mu nda tokë e ku present ka qenë edhe vajza. Në vitin 2011 R. dhe R. kanë ardhë ku kanë kërkuar të ndahet toka, ndërsa takim për me nda tokën nuk kemi pas deri në vitin 2019, ndërsa në vitin 2019 me 08.03.2019, janë takuar vëllëzerit për ta ndarë tokën ku ka qenë R., vëllau R. G., ka qenë edhe i njëjti e ku ka qenë edhe dëshmitarët E. E., Rr. E., Fazli E., I. G., ndër kohë ka biseduar me motren H. para se të bisedoj rreth ndarjes së tokës e ku ajo i ka thënë se unë në hise nuk hi në tokë të babës me përjashtim të livadhit që edhe unë kam marrë pjesë me shumën prej 12.000,00-DM du që vëllëzerit kur të ndaheni me mi kthy këto 12,000,00-DM, që i ka dhënë në emër të çmimit të shitblerjes së livadhit në sipërfaqe prej 41 ari e i cili është blerë në vitin 1996. Po atë ditë në atë takim është bërë marrëveshja për ndarjen e tokës komplet, e ku mue edhe J. G. na ka ra livadhi komplet që e kemi blerë prej J. G., e cila sipërfaqe mendoj se është prej 68 ari. Pas tre muajve pas kësaj date ka ardhë R. vëllai i madh nga Gjermania dhe i ka thënë se nuk i pelqen kjo ndarje e tokës dhe i njëjti ka thënë se e ka blerë këtë pjesë me pare të mija dhe dëshiron të marrë vetë, marreveshjen e sipërpërmendur e kemi bërë me shkrim dhe ja kanë dorzuar gjykatës dhe ja ka dhënë të gjithëve vëllëzerve dhe dëshmitarët të cilet kanë qenë present i ka thirrë vëllau i madh R. ndërsa procesin e ka mbajti R. G., H. ka heq dorë nga trashëgimia me përjashtim të hollave që i ka kërkuar ndërsa Q. nuk ka qenë në jetë në atë kohë e njëjta ka vdekur në vitin 2012 dhe se i njëjti edhe më tutje qëndron pranë marrëveshjes së arritur në vitin 2019 për ndarjen e tokës. Prej vitit 1991 e tutje vëllëzerit nuk i kanë ndihmuar asgjë, ndërsa tokën e kanë ndarë në vitin 2019 siç ka deklaruar dhe se nuk ka tokë që është blerë vetëm me kontributin e R.. Prej vitit 1991 R. ka qenë kryefamiljar dhe nuk di se R. i ka dërgu diçka mjete familjes, ndërsa i njëjti ka punu vazhdimisht në shtëpi dhe e ka shoqëruar prindin në punë. Në fshatin H. është vetëm shtëpia që ka maru prindi në vitin 1977 dhe 78 ndërsa e ka renovu mas lufte dhe vëllëzerit nuk kanë maru shtëpia në fshatin H. poashtu shtëpia dhe shtalla kur janë ndarë të gjitha i kan ra mu, ndërsa as që është bisedu që në emër të shtëpive në emër të dikujt.

Nga dëshmia e të paditurit **J. G.** në cilësin e palës në procedurë ka deklaruar se deri në vitin 1991, kemi qenë të gjithë në një bashkësi familjare vëllëzerit, motrat dhe prindërit, në vitin 2011, 2017 dhe 2019 është bisedu për ndarjen e tokave që i kanë pas nga prindi dhe familja jonë që kemi pas. Në vitin 2019 janë marrë vesh për ndarje të tokave, kanë bërë edhe procesverbal me shkrim si të ndahen tokat dhe pasuria e prindit, e ku present une nuk kam qenë por është njoftuar nga vëllau M. se prezente kanë qenë nipat dhe vëllëzerit, pasuria e përbashkët është krijuar me kontributin e të gjithë familjes vëllëzerit, motrave dhe prindërve dhe se asnjëherë nuk është folur se parcelat nr.513 dhe 516 i takojnë ndonjërit prej vëllëzerve. Poashtu ka theksuar se trashëgimin M. e ka kry me qëllim që ti merr suvencionet ndërsa pasuria që është shqyrtuar me aktvendim të trashëgimisë dhe është dalë në emër të M. është pasuri e babës së ndjer, asnjëher R. nuk ka paraqit kërkesë dhe asnjëher nuk është bisedu se këto dy parcela dhe pjeset tjera sipas marrëveshjes i takojnë ati. Tokën e përbashkët vëllëzerit të cilet kanë qenë në perëndim nuk e kan kontestu asnjëher që ta punoj M. ndërsa M. ka qenë me prind dhe e ka punu këtë tokë, R. kurr nuk ka kontribu në rritjen e pasurisë së përbashkët, por edhe unë nuk kam kontribu në rritjen e pasurisë së përbashkët, ndërsa rritjen e pasurisë së përbashkët kanë kontribu prindërit e tyre, ka kontribu edhe M. sepse ai ka qenë këtu në vendlindje me punen që e ka bërë në familje duke punuar token dhe punë tjera të shtëpisë, në vitin 2019 është nda pasuria e përbashkët për këtë është hartuar procesverbal me shkrim dhe toka është ndarë ashtu siq është shkruar në procesverbal ku shtëpia me shtallë i kan mbet M. respektivisht për to nuk është bisedu aspak.

Nga dëshmia e paditësit **R. G.** në cilësin e palës në procedurë ka deklaruar se në shtetin e Gjermanisë ka shkuar në vitin 1973 ku edhe ka punu deri në vitin 1991, ka qenë i vetëm pa familje të ngushtë, për familje ka blerë traktor 14.000,00-DM, diku mas viteve 89, 88 dhe në vitin në vitin 86, 87 ka blerë automjet Lladë të re për qmimin prej 8.000,00-DM, automjet këtë të cilin ja ka lënë në shtëpi familjes. Vëllai S. është dalë në Francë ndërsa J. në Zvicër dhe me babën ka bisedu dhe i ka thënë nëse këta nuk blejnë tokë, tokën që unë e kam blerë unë nuk muj me ja nda, tokën që unë e kam blerë le ta shfrytëzojn deri në kohën kur vjen dita që ne vllëzërit me motra të ndahemi. Me parët e mija janë blerë livadhi në sipërfaqe prej rreth 65 ari, janë blerë prej E. G., prej D. G. dhe një pjesë prej A. G., një arë është blerë prej B. G. e cila ka sipërfaqe prej rreth 41 ari këta e ka blerë në vitin 1996. Poashtu ka theksuar se familjen gruen me fëmijë, ka fitu pare me punë dhe shtesat që i ka marrë për fëmijë dhe këto pare i ka shti në tokë duke mendu se kur të ktheht një ditë në Kosovë, meqense nuk ka shkoll të madhe të punoj tokën dhe se marrëveshjet për shitblerje e tokës në emrin të tij i ka bërë vëllau R. dhe babai. Ndërsa rreth 86 ari afër shtëpijave tona i kemi blerë si familje bashkarisht me punën që kemi bërë në Kosovë dhe 50 ari tokë në breg të R. janë blerë me punën e përbashkët si familje, kemi prerë qerpiq dhe të cilat hala nuk i kemi përkthi dhe toka që është në emër të babës së ndjerë pajtohet me ndan në shtat hise dhe se vëllau M. G. e ka shitë një arë në sipërfaqe prej 43 arë pa na pytur neve motrave dhe vllëzërve. Në vitin 2019, kemi bërë një tentim për tu marrë vesh me vllazër dhe motra me nda tokën dhe nuk kemi mundur përsëri me arrit marrëveshje për shkakun se motrat nuk ishin prezentë dhe kisha qef të ishin të gjithë prezent dhe të ja bëjë me dije se tokën që kam blerë unë du me marrë dhe tokën që kemi blerë pa shku në Gjermani dhe tokën e babës ta ndajmë bashkarishtë dhe tokën e përbashkët që ka punu M. ja ka lënë me vullnet me punu ndërsa vllëzërit tjerë kanë kërkuar me u nda sa ma shpejt. Deri sa ka qenë në Gjermani M. dhe J. nuk kanë punuar nga se kanë qenë nxënës në shkollë, ndërsa Q. ka punu në familje si anvisë, ju ka ndihmu prindërve ka punu në bashqë dhe tokën ja ka lënë me punu vëllaut M. e jo me marrë dhe me kthye mbi veti dhe nuk e kthen tokën e tij mbi vete kurr nuk e ka menduar dhe këto dy ara që i ka ble me para të tija edhe që janë në emër të babës dëshiron ti marrë, ndërsa pasurin tjetër që është në emër të babës me nda në 7 vende, parcelat që i ka blerë ara rreth 40 ari dhe arën – livadhin që ka rreth 65 ari e i cili është afër shtëpis ka kërkuar që ti jepet atij.

Nga dëshmia e paditësit **R. G.** në cilësin e palës në procedurë ka deklaruar se ka punuar si polic në Kosovë që nga viti 1981, ndërsa në vitin 1991 ka shku në Gjermani me punu dhe ka shtuar se toka që është në emër të ndjerit, por edhe do e kanë të pa përkthyer që e ka blerë babai edhe ajo me tokën e përbashkët ndahet në 7 pjesë, ndërsa R. ka blerë tokë përafërsishtë dy hektar e tridhjet ari me parët e veta në ZK H. i V. dhe atë e ka blerë arën që na i thojna ara Mas Smalit përafërsishtë 67 ari, janë blerë prej serbëve, mandej arën përtej Gj. që na e quajm përafërsishtë 41 ari, janë blerë prej B.G. e që tani R. i ka qitë në emër të vet, e cila është afër shtëpisë pasaj e ka blerë edhe Livadhin përfundi shtëpisë në sipërfaqe prej 65 ari ky livadh është blerë prej E. G., D. G. dhe A.G. e që ky livadh tani është në emër të D. G. të vëllaut M. G., mandej është blerë ara përsëri mas Gj. në sipërfaqe prej 40-41 ari e cila është hala në emër të koperative dhe kjo parcelë është blerë me parët e përbashkëta, vllëzërve dhe motrave, prindërve. Poashtu ka shtuar se kanë bërë përpjeke me arritë që me marrëveshje me nda tokë por nuk kanë mundur që të mirren vesh, se krejt tokën ja kanë lënë M. G. me punu deri në vitin 2019 kur kemi ardhë me u marrë vesh me nda tokën dhe në vitin 2019 nuk kemi mundur që të mirren vesh me nda tokën duke shtuar se i njëjti dëshiron që tokën që është në emër të babës dhe atë që ka blerë babai të përbashkët secili të marrë hisën e vet dhe unë hisen time dhe atë kjo tokë me u nda në 7 hise për vllëzër dhe motrat ndërsa tokën që e ka blerë R. G. le ta merr R. nga se ai e ka blerë me parat e veta, arën në sipërfaqën prej 65, mas S. dhe livadhin i cili është në sipërfaqe prej 150 ari ndërsa nga ky livadh R. i takon një hektar e gjasht – shtatë tetë ari, mandej edhe ara mas Gj. në sipërfaqe prej 42 ari i takon R. nga se edhe këtë arë R. e ka blerë me pare të veta kur është kon në Gjermani dhe kur është blerë toka nuk është përmend se kujt do ti takoj dhe këtë nuk e di se babai e ka përmend, në prezencë time asnjëher nuk e ka përmend se për kënd po blehet kjo tokë, prej vitit 1991 kur ka shkuar në Gjermani vëllau M. është mbet me pasurin të cilën Rama e ka blerë me

paret e tij, ndërsa para këti viti ka qenë në shkollë, ndërsa pas vitit 1991 M.ka punu por nuk ka mundur me kriju pare për me ble tokë. Që nga viti 2000 kanë bërë përpjekje për ta ndarë tokën sa ka qenë nëna gjallë e cila ka vdekur në vitin 2003, mandej kemi bërë përpjekje me nda tokën në vitin 2011 por M.nuk është pajtuar, ka mbetë pa u ndarë ndërsa vetëm pasi ne kemi shku në perendim pas dy muajve M. e ka përkthyer tokën në emër të vet krejt toka që ka qenë në emër të babës. Në bashkësi familjare kanë jetuar deri në fund të vitit 1991, kur me familje ka shkuar në Gjermani ndërsa M. ka mbet me prindërit dhe motrën H. në shtëpi në fshatin H., ndërsa tokat nuk i kemi ndarë asnjëher dhe se tokat ka vazhdu ti punoj vëllau M. edhe masi i njëjti ka shkuar në Gjermani, kena kërkuar mas vitit 2000 që të na ipet hisja e jonë dhe kemi kërku me u nda toka, e as nëna e ndjerë dhe as M. nuk kanë ra dakort me u nda toka ku nëna thojke le ta punon M. tokën mos ta ndajm. Poashtu ka theksuar se edhe ato ara janë blerë në kohën sa kanë qenë në bashkësi familjare ndërsa masi unë kam shku në Gjermani në vitin 1991 vetëm Rama e ka blerë edhe një arë në vitin 1996 por ma herët nuk është blerë. Më tutje shton se në vitin 2019 është ardhë R. prej Gjermanisë dhe kemi bërë përpjekje mu marrë vesh me nda tokën dhe në këtë kohë nuk e kemi ditë që M. e ka shqyrtuar trashëgimin e tokës së babës dhe e ka qitë në emër të vet dhe një pjesë e ka lënë në hipotek.

Nga dëshmia e paditëses **H. G.** në cilësin e palës në procedurë ka deklaruar se ka jetuar me prindërit dhe vllëzërit deri në vitin 1993 kur ka shku në shtetin e Gjermanisë dhe ku edhe ka punuar dhe ka hyrë në rend me vëllazërit R. dhe R. me ju dërgu pare familjes në Kosovë dhe pare ju kemi dërguar me rend një herë unë, herën e dytë Rama, herën e tretë R., deri në vitin 2000 dhe prindërit e mi në Kosovë nuk e kan ditë se na po ju dërgojna me renë pare. Me dt.07.08.2000 Gjermania me ka kthy në shtetin e Kosovës, ka ardhë në shtëpi të babës ku baba i ndjerë nuk ka qenë gjallë ku nëna ka qenë gjallë. Me 27 shtator të vitit 200 është punësuar në Prizren një kuzhinë të UNMIK-ut ku ka punuar deri në vitin 2008 dhe masi ka filluar me punu ka banu në Prizren por javë për javë ka ardhë tek nëna. Në vitin 2008 ka shku në Belgjikë ku është edhe sot e kësaj dite. Metutje ka shtuar se baba i ndjerë na ka lënë trashëgimi tokat dhe atë ara mas shpije në sipërfaqe prej 87 ari, kjo parcel nuk është hala e përkthyer, ara te Jashari është në sipërfaqe prej 42 ari, livadhi i rrafshit është 55 ari, ara te Murrizi është 43 ari ara te Hallai i Madh është 39 ari edhe një arë është në emër të Koperativës është 40 ari dhe krejt bëjn 4 hektar e 53 ari ku kjo tokë duhet me u nda në 7 vena, ndërsa arat vëllai madh R. që i ka blerë me pare të veta janë ara mas Gj. është 42 ari, ara mas S. është në sipërfaqe prej 67 ari dhe livadhi para shtëpisë është në sipërfaqe prej 65 ari, këto tri parcela R. i ka blerë me pare të veta dhe meqense i ka blerë me pare të vete R. unë jam e pajtimit që këto tri ara me i marrë R.. Poashtu ka theksuar se është e pajtimit që këto tri ara që i ka blerë me pare të veta ti merr R. për arsye se i njëjti ka punuar në gurbet larg familjes larg fëmijëve dhe deri në vitin 1991 i ka marrë fëmijët dhe gruen në Gjermani pasi është bërë helmimi i nxënësve është bërë në shkolla tona dhe se qdo herë ka mendu me ble tokë dhe mu kthy me jetu në Kosovë dhe pare për me blerë tokën nuk ka dhënë as unë as M. as R., deri në vitin 1991 kemi jetu në bashkësi të përbashkët familjare, se tokat të cilat po i kërkon R. mi marrë janë blerë para vitit 1991 dhe e njëjta qdo herë ka menduar se tokën që po e blen R. është e tina, ndërsa nuk ka ndëgju se është përmend se kjo tokë po blehet për R. por qka ka thënë R. dhe baba ne nuk e kemi kundërshtu.

Mbi bazën e këtyre provave në pa mëdyshje u vërtetua se palët ndërgjyqëse janë pasardhës të të ndjerit H. G. ish nga fsh. H. i V. K. L., ku me vendimin e trashëgimisë T.nr.... të dt.02.09.2011 është shqyrtuar pasuria trashëgimore e të ndjerit pra ngastrat që janë lënd e padisë me përjashtim të ngastrës kadastrale që është e përshkruar në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit e cila ka mbetur pa e shqyrtuar, për të njëjten është shpallur trashëgimtar i vetëm ligjor, i padituri M. G.nga fsh. H. i V., i biri i të ndjerit. Ky i fundit gjatë nxjerrjes së aktit të vdekjes për të ndjerin nuk i ka paraqitur të gjithë pasardhësit dhe në këtë mënyrë e ka paraqitur vetën si pasardhës të vetëm duke i përjashtuar të tjerët nga e drejta në trashëgimi. Poashtu mbi bazën e provave e veçanërisht mbi bazën e certifikatave të lindjes por edhe nga deklarimi i palëve në procedurë që nuk ka qenë kontestuse u vërtetua se paditësit R. G., R. G., S. G., H. G. janë pasardhës të të ndjerit H. G. dhe poashtu të paditurit M. G., . G. dhe Q. G.-Krivaqa e cila ka

ndërruar jetë me dt.26.04.2012 ku si pasardhës sipas të drejtës së përfaqësimit ka lënë M. dhe M. K. si dhe H. K.-Z., pra të gjithë pasadhësit e të ndjerit në 7 hise varësisht se si do ta kërkonin të drejtën në trashëgimi.

Me dispozitat e nenit 20 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko-Pronësore, parashifet se e drejta e pronësisë fitohet sipas vetë Ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me Trashëgim.

Me dispozitat e nenit 12.1 të LTK-së parashifet se “Trashëgimlënësin e trashëgojnë para të gjithëve fëmijët e tij dhe bashkëshorti i tij. Personat nga paragrafi (1) i këtij neni trashëgojnë në pjesë të barabarta. Me nenin 13 parashifet se kur një nga fëmijët ka vdekur para trashëgimlënësit, në vend të tij hyjnë me zëvendësim fëmijët e tij, e kur edhe të paslindurit për shkaqet e parapara me Ligj nuk mund të jenë trashëgimtarë, hyjnë në trashëgim të paslindurit e tyre pa kufizim. Personat nga paragrafi (1) i këtij neni trashëgojnë në pjesë të barabarta”.

Pra, bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike dhe dispozitat materiale të lartpërmendura u vërtetua se paditësit R., R., S. G. dhe H. G. nga fsh. H. i V. janë fëmijë të të ndjerit H. G., pra pasardhës të tij që renditen në rendin e parë të trashëgimisë e të cilit nuk janë lajmëruar me rastin e shqyrtimit të trashëgimisë të të ndjerit nga i padituri M. G., i cili ky i fundit është fëmijë i trashëgimlëndësit dhe të gjithë masën e trashëgimisë e ka trashëguar me përjashtim të ngastrës të përshkruar në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit e cila ngastës ka mbetur ende në emër të të ndjerit. Poashtu u vërtetua se edhe të paditurit e tjerë J. G. dhe Q. G. janë fëmijë të trashëgimlëndësit dhe kjo e fundit ka vdekur dhe si pasardhës ka lënë fëmijët M. dhe M. K. si dhe H. K.-Z., që paraqiten në rendin e parë të trashëgimisë sipas të drejtës së përfaqësimit, e kanë fituar të drejtën e pronësisë mbi bazën e trashëgimisë paditësit R. G., R. G., S. G. dhe H. K.-Z. secili në pjesën ideale nga 1/7 e pasurisë trashëgimore të trashëgimlëndësit pasi që i ndjeri pas vdekjes kishte lënë shtatë pasadhës dhe gjatë gjithë procedurës i padituri nuk ia ka kontestuse paditësve të drejtën e pronësisë mbi bazën e trashëgimisë, andaj nga këto arsye dhe dispozitat e lartpërmendura gjykata ia njohi të drejtën e pronësisë paditësve.

Gjithashtu gjykata e aprovoj kundërpadinë e të paditurit M. G. me të cilën ka kërkuar fitimin e pronësisë në 3/7 të pjesës ideale të ngastrës nr... që gjindet në ZK R. i V. dhe që regjistrohet ende në emër të paraadhësit të palëve ndërgjyqëse dhe me pajtimin e palëve ndërgjyqëse gjykata ia njohi të drejtën e pronësisë në këtë parcelë paditësve nga 1/7 e pjesës ideale, ndërsa të paditurit-kundërpaditësit M. G. ia njohi të drejtën e pronësisë ia njohi të drejtën e pronësisë në 3/7 e pjesës ideale, pasi që nuk ka qenë kontestuse nga paditësit-kundërtëpaditurit dhe nuk e kanë kundërshtuar paraqitjen e kundërpadisë në shqyrtimin gjyqësor me qëllim që krejt kjo të zgjidhjes së çështjes.

Me rastin e vendosjes në këtë çështje kontestimore, gjykata vlerësoi pretendimet e palëve ndërgjyqëse ku të gjithë një zëri janë dakorduar për zgjidhjen e kësaj çështje në këtë mënyrë dhe nuk e ka kontestuar pretendimet e njëra tjetrës.

Sa i përket propozimit të palës paditëse për zgjerimin e padisë tek i padituri J. J. nga Prishtina me të cilin ka kërkuar anulimin e kontratës së shitëblerjes ku ky i fundit e ka blerë një parcel nga i padituri M. G., gjykata e refuzoj propozimin e palës paditëse për zgjerimin e padisë në kuptimin subjektiv me arsyetimin se pala paditëse disa herë e ka precizuar dhe zgjeruar padinë dhe kjo vetëm do ta zvarriste zgjidhjen e çështjes sepse zgjerimin në fazë të fundit të shqyrtimit nuk është e lejshme dhe anulimin e kontratës nuk mund të kërkohet kur ky i fundit e ka fituar pronësinë në mënyrë të rregullt dhe mbi bazën e kontratës të vërtetuar tek zyra noteriale por i njëjti mund të kërkoj pjesën e çmimit të shitjes nga i padituri M. G. në atë pjesë sa kanë kërkuar vërtetimin e pronësisë për masën e trashëgimisë.

Meqenëse pala e paditur asnjëherë nuk e ka kontestuar padinë e paditësve mbi këtë bazë nga këto arsye gjykata ia njohi shpenzimet e procedurës palës paditëse vetëm shpenzimet e nevojshme dhe atë konform nenit 452 dhe 453 të LPK-së e detyroj palën e paditur që palës paditëse t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë për për përpilimin e padisë në shumë prej 312-€, dhe për dy seanca gjyqësore shumë nga 2x405.60-€=811.20-€, për taks gjyqësore shumë prej 40-€, apo shumë e përgjithshme prej 1,163.20-€, shpenzime këto

që kanë qenë të nevojshem për përfundimin e këtij kontesti të llogaritura me vlerë të kontestit të vogël deri në 10,000.00-€, dhe të rritura për 50% për secilin të paditur deri tek i pesti, më konkretisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në bazë të të gjitha arsyeve që u paraqitën më lartë dhe dispozitave të lartëcekura, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË LIPJAN**  
**C.nr.423/19 me dt.28.01.2025**

**GJYQTARI**  
**Avdirrahman Gashi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të së njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate.